FORTEX nutraceuticals

Plagosi me armë nënë e bir në Durrës pas konfliktit për vendin e parkimit, arrestohet autori, shpallen në kërkim dy të tjerë (EMRAT)

Publikuar tek: AKTUALITET, më 09:42 24-02-2021

Erges Juba, është personi që ka rënë në prangat e Policisë, pasi mbrëmjen e djeshme ka qëlluar me armë nënë e bir në Durrës, duke i plagosur. Konflikti ka nisur për një vend parkim, në lagjen nr. 12, Durrës.

Fillimisht u përplasën me sende të forta Orges Çerma dhe Zyber Juba. Si pasojë e goditjeve u lëndua Juba, i cili u dërgua në spital për ndihmë mjekësore. Më pas konflikti u përshkallëzua me përdorimin e armës së zjarrit dhe si pasojë mbetën të plagosur nënë e bir.

Fillimisht u dyshua se autor i kësaj ngjarje ishte shtetasi Zyber Juba, por pas hetimeve, rezultoi se shtetasi Ergys Juba (i arrestuar), pas konfliktit të ndodhur midis vëllait të tij me Orgesin, ka qëlluar me armë zjarri drejt shtetasit Flamur Çerma, 23 vjeç dhe shtetases Valbona Çerma, 51 vjeçe (e ëma), të cilët ndodhen në spital nën kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Në vijim të hetimeve është bërë shpallja në kërkim e shtetasve Altin Juba, 34 vjeç (vëllai i autorit) dhe Olsian Nexha, 28 vjeç, pasi rezultoi se këta shtetas, në bashkëpunim me shtetasin Erges Jubën, kanë konsumuar veprat penale "Vrasja e mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim" dhe "Armëmbajtja pa leje".

Njoftimi i policisë:

Zbardhet dhe dokumentohet me prova ligjore, ngjarja e ndodhur mbrëmjen e djeshme, ku mbetën të plagosur me armë zjarri nënë e bir.

Kapet dhe vihet në pranga autori kryesor i dyshuar për plagosjen e dyfishtë.

Sekuestrohet arma e zjarrit pistoletë.

Shpallen në kërkim dhe 2 bashkëpunëtorët e autorit të ngjarjes, të cilët u përfshinë në konflikt, si dhe procedohet penalisht 1 shtetas tjetër.

Strukturat hetimore të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, pas një pune intensive për zbardhjen e ngjarjes së ndodhur mbrëmjen e djeshme, bënë zbardhjen e saj dhe identifikimin e autorit kryesor të ngjarjes. Në bashkëpunim me DVP Elbasan u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit E. J., 33 vjeç, banues në Peqin.

Mbrëmjen e djeshme, në lagjen nr. 12, Durrës, ka ndodhur një konflikt i çastit për motive të dobëta (për vende parkimi), fillimisht me sende të forta, midis shtetasit O. Ç. dhe Z. J.

Si pasojë e goditjeve u lëndua shtetasi Z. J., i cili u dërgua në spital për ndihmë mjekësore. Më pas konflikti u përshkallëzua me përdorimin e armës së zjarrit dhe si pasojë mbetën të plagosur nënë e bir.

Fillimisht u dyshua se autor i kësaj ngjarje ishte shtetasi Z. J., por pas hetimeve të shpejta dhe profesionale, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës , rezultoi se shtetasi E. J. (i arrestuar), pas konfliktit të ndodhur midis vëllait të tij, shtetasit Z. J. dhe O. Ç., ka qëlluar me armë zjarri drejt shtetasit F. Ç., 23 vjeç dhe shtetases V. Ç., 51 vjeçe (e ëma), të cilët ndodhen në spital nën kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Në vijim të hetimeve është bërë shpallja në kërkim e shtetasve A. J., 34 vjeç (vëllai i autorit) dhe O. N., 28 vjeç, pasi rezultoi se këta shtetas, në bashkëpunim me shtetasin E. J., kanë konsumuar veprat penale "Vrasja e mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim" dhe "Armëmbajtja pa leje", si dhe u procedua penalisht shtetasi O. Ç. (vëllai i shtetasit F. Ç.), për veprën penale " Dëmtime të tjera me dashje".

Gjithashtu, në vijim të veprimeve shërbimet e Policisë kanë krehur zonën dhe kanë bërë të mundur gjetjen e armës së zjarrit, të cilën autori pas ngjarjes e kishte hedhur në distancë të largët nga vendi i ngjarjes.

Nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës vijon puna për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë konflikt.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprat penale "Vrasja e mbetur në tentativë", "Armëmbajtja pa leje" dhe "Dëmtime të tjera me dashje".

Modifikuar më 09:50 24-02-2021

SONDAZH

Facebook Twitter Google Plus Whatsapp

Më shumë në këtë kategori: « U vranë nga Përparim Ademi ditën e Vitit të Ri, motra e Zhanetës dhe Kristinës hap gjyq: Kërkon kujdestarinë e nipit 14 vjeçar Privatizimi i kompleksit 'Partizani', Frrok Çupi sulmon dhëndrin e Berishës: Ka ndërtuar 17 kulla, ku i gjeti paratë që manipuloi 64 ish-pronarë, rracë budallenjsh »

KONTROLLO LISTËN E ZGJEDHËSVE
Nëse emri yt nuk gjendet në listën e zgjedhësve, ose nëse të dhënat tuaja në listë nuk janë të sakta, drejtohu tek ZYRA E GJENDJES CIVILE të njësisë administrative ku banon.
ZGJIDH, VOTO, VENDOS!
Në 25 Prill 2021 votohet për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

KODRA VILA, APARTAMENTE
+355 67 206 4402
info@kodraediellit.com


PA STRES nga Edi Oga
1 herë në javë
Satirë, humor, sarkazëm...

TESS TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL
APLIKO TANI ›

FOTO E DITËS

Ndahet nga jeta kompozitori i serenatave korçare Naum Tërova

Kompozitori i i serenatave korçare Naum Tërova, është ndarë nga jeta mbrëmjen e djeshme pasi nuk e ka fituar dot betejën me Covid-19.

Terova ishte prej ditësh i shtruar në pavionin e pneumologjisë të Spitalit Rajonal Korcë, aty ku edhe ndërroi jetë, pasi nuk mundi ta mposhte virusin. Korça ka humbur një figurë të madhe, pasi ishte një nga personalitetet e shquara dhe të njohura në qytet e më gjerë.

Terova është babai i nënkryetares së Bashkisë Korcë, Benila Terova.

E Premte 22:00

Aksidenti tragjik te 'Rruga e Kombit', viktima është një i ri 33-vjeçar (EMRI)

Barometri i Ditës

2 Vrasja e Behar Sofias, Artan Hoxha: Mesazh për t'u futur tmerrin të tjerëve

2 E vendos KOMITETI: Mbeten në fuqi masat anti-Covid, mbyllen shkollat, universitetet dhe baret

1 Përplasjet me sekretarin Sali Shehu, kreu i FRD-së Bamir Topi jep dorëheqjen

1 Ekzekutimi i i Behar Sofisë te Piramida, Klodiana LALA jep detaje: Policia e konsideronte '1-shin' e trafikut të heroinës



1 Gazment Bardhi e zbulon: Dje kallzova në SPAK Taulant Ballën, vartësit e tij kërcënojnë qytetarët me telefon



NEWS SPORT

Kliko këtu për të parë videot
BOMB VIDEO

Raiffeisen BANK
HAP LLOGARI BANKARE ONLINE NË 15 MINUTA

Spitali Amerikan Përqafoje jetën!
042 35 75 35 24h

HOROSKOPI 2020

SHTYPI I DITËS

TARIFA: BASHKIMI KOMBËTAR DHE SOCIALISTËT SHQIPTARË, TË DJESHMIT DHE TË SOTMIT
DITA
BUKA E VJETER E OPOZITËS
25 PRILLI DHE ÇETA PLAKË E BASHËS SI NJË TRASHËGIMI POLITIKE NGA PARARENDËSI

SONDAZH

ANALIZA & KOMENTE

Vaksinimi i të moshuarve të famshëm, gazetari: Para ligjit dhe Zotit jemi të barabartë, por jo në shoqëri (E PLOTË)
Shkruan Mentor Kikia Të moshuarit e famshëm dhe historia komike e

"Një leksion falas që na dha kardiologu i pasur"
Shkruan Denis Dyrnjaja: Rasti i mjekut Edvin Prifti na nxorri në p

Kosovë-Izrael, pse është i rëndësishëm procesi i njohjes së shteteve
Nga Akri Çipa Vendosja e marrëdhënieve të plota diplomatike me

"Jetët tuaja nuk shkuan dëm. Gjaku juaj shërbeu për të treguar fytyrat e vërteta të Saliut, Ilirit, Lulit dhe Edit..."
"Ziver, Hekuran, Faik dhe Aleks, sido të vejë, jetët tuaja nuk sh

Më 25 prill nuk do të ndodhë asnjë çudi, të dashur demokratë!
Nga Mustafa Nano Duket se demokratët janë përgatitur për humbje

Shteti u shfaq pa brekë, krimi mbeti te 30 mijë lekëshi! Kjo është paradhoma e çdo diktature apo qelia e çdo demokracie
Nga Ergys Mertiri Fillimisht ju kërkoj ndjesë që nuk kam mundur ti

"Pse duhet të turpërohemi përpara Qazim Rashës"
Nga Astrit Patozi Qazim Rasha me siguri që nuk ka dashur kurrë t�

DOSSIER

DOSSIER/ Janar 1991, Zenel Hoxha rrëfen: Si krijuam degën e parë të PD së Lushnjes në shtëpinë e Kujtim Ginës, përplasjet me shefin e policisë (KUJTIME – FOTO)
Kaluan 30 vite qe nga krijimi I degës së Partisë Demokratike në qy

Albina Marashi, 6-vjeçarja që pa babain të varur në mes të Shkodrës
Shkrim-homazh nga Lek Pervizi Ishte vetëm 6-vjeç, mosha kur krijo

Vepra e fundit dhe amaneti i Fatos Baxhakut, ja mesazhi i gazetarit të njohur për kolegët e rinj
Fatos Baxhaku la gjurmën e tij të fundit në gazetarinë dhe median

105 vite më parë/ 28 qershori 1914, 'Atentati i Sarajevës' dhe 'atentati ndaj Shqipërisë'
Nga Armand PLAKA Sot e 105 vite më parë, më 28 qershor 1

Sa flori nxirrej në Rubik para viteve '90? Publikohen dokumentet tepër sekrete
Prej vitesh në media është raportuar lidhur me sasin&eu

Si sot 70 vite më parë, publikohen fotot rrënqethëse të dy ish-deputetëve që u pushkatuan nga sistemi komunist
Historiani Kastriot Dervishi ka publikuar sot pamjet rrënqeth&eum

BOMB- HISTORI: Si spinuan çekët Kombinatin e Elbasanit, investimin më të rëndësishëm (DOKUMENTI)
Nga Çekia, Erald Kapri për newsbomb.al Ndërtimi i

POLITIKË

Taulant Balla i përgjigjet Gazment Bardhit për padinë në SPAK: Kur të dalë rezultati i zgjedhjeve në Elbasan, Gazi do kallëzoj për tradhëti të lartë gjithë PD-në e Elbasanit
Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste Taulant Balla i është përgjigjur drejtuesit politik të PD-së...

Djali i Sokol Olldashit flet për zgjedhjet e 25 prillit dhe marrëdhënien me Berishën, ja si i komenton veprimet e Hajdarit dhe deklaratën e Topallit
Glauk Olldashi, djali i madh i ish-deputetit të PD Sokol Olldashi ka folur në prag...

Damian Gjiknuri takim me socialistët në Vlorë: Një grup simpatizantësh ikën nga LSI, u bashkuan me ne
Drejtuesi politik i PS për Vlorën, Damian Gjiknuri, ka zhvilluar një takim me ish0simpatizantë të...

STILISTE, STUDENTË dhe EMIGRANTI në Itali, Kujtim Gjuzi publikon listën e kandidatëve të Partisë Konservatore, "harron" të vendosë emrin e tij
Deputeti Kujtim Gjuzi, njëherësh edhe kryetar i Partisë Konservatore Albania, ka publikuar në rrjetet sociale...

AKTUALITET

Aksidenti tragjik te 'Rruga e Kombit', viktima është një i ri 33-vjeçar (EMRI)
Një aksident i rëndë ka tronditur vendin mbrëmjen e sotme, ku një person mbeti i...

Mira Rakacolli: Të hënën vijnë në Shqipëri 15 mijë doza të vaksinës së Pfizer. Po bëjmë përpjekje për të siguruar më shumë
Zv.ministrja e Shëndetësisë Mira Rakacolli ka deklaruar ditën e sotme se të hënën do të...

Epidemiologu Ilir Alimehmeti: Të saktësohen sa teste e tampone bëhen në ditë, herët për të thënë kemi ulje të rasteve
Epidemiologu Ilir Alimehmeti ka folur për situtën e pandemisë në vendin tonë, ku është shprehur...

Olti Curri i bën thirrje Drejtorisë së Tatimeve: Verifikoni VIP-at që bëjnë postime dhe "giveaway" pa faturë dhe pa paguar detyrimet
Blogeri i njohur Olti Curri i ka bërë thirrje Drejtorisë së Tatimeve të verifikojë "VIP-at"...

EKONOMI

Shtrenjtohet me 25% çmimi i gazit për makinat, kosto shtesë edhe për familjarët
Çmimi i gazit është shtrenjtuar javëve të fundit si për ata që kanë të instaluar...

Miliardat jashtë bankave kapin rekordin që pas krizës 2002, çfarë ndodhi në pandemi
Në fund të vitit 2020, jashtë sistemit bankar qarkullonin 344 miliardë lekë (2.8 miliardë euro),...

Më shume se 1 trilion lekë, ja sa është pasuria financiare e shqiptarëve
Pasuria financiare e shqiptarëve vlerësohet të jetë pak më shumë se një trilion lekë ose...

Rënia ekonomike nga Covid-19 do të shtojë numrin e të varfërve në nivel global
130 milionë njerëz më shumë nuk kanë ushqime të mjaftueshme. Në vitin 2021, varfëria do të...

KULTURË & ARTE

'Bolero në vilën e pleqve', filmi shqiptar ngjitet në festivalin e Torontos, 3 çmime të fituara
Filmi shqiptar "Bolero në vilën e pleqve" me regji të Spartak Pecanit fiton një tjetër...

150-vjetori i shkrimtares së shquar ukrainase Lesya Ukrainka
25 shkurt 2021 shënon 150 vjetorin e lindjes së Lesya Ukrainka - shkrimtarja e shquar...

Meta vlerëson me Titullin "Mjeshtër i Madh" aktorin Petrika Riza: Artistët janë krenaria e vendit, janë frymëzim për brezat
Presidenti i Republikës, Ilir Meta dekoroi me Titullin "Mjeshtër i Madh" aktorin e mirënjohur korçar...

VIDEO: "Një natë me Sheyda Do'a"
Sheyda Do'a, një muzikante shumëdimensionale sjell sonte në mbrëmje në RTSH1, koncertin e saj recital...

FCB-BOMB

Ironia e shkodranëve: Jozefina me dy muaj parti prezantoi vajza e djem të shkolluar në përëndim. Luli prezantoi…Bamir Topin!
Ditën e djeshme ish-kryeparlamentarja Jozefina Topalli prezantoi një grup të rinjsh e të reja që...

Rama poston videon: Nuk është 'Game of Thrones', është kalaja e Beratit
Kryeministri Edi Rama ka postuar një video nga kalaja e Beratit, e cila duket e...

Gruaja i vdiq nga ataku kardiak, burri nga Roskoveci çon në prokurori mjekun: Na sorollati në klinikë private, humbi jetën nga neglizhenca
Një qytetar nga Roskoveci ka paditur në prokurorinë e Fierit mjekun Viktor Gjini. Sipas tij, ai...

Shoqëruesi i Ramës harron kamerën HAPUR, SHIKONI çfarë filmon! Kryeministri i habitur: Pse ishim live?!
Kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Shëndetësisë Ogerta Manastirliu kanë vizituar sot pikën e vaksinimit...

RAJON

ATENTAT shqiptarit në mes të Athinës, dy autorët ikin me taksi, por harrojnë armën në makinë (FOTO-VIDEO-DETAJE)
Një shqiptar, identiteti i të cilit ende nuk dihet, është qëlluar me armë zjarri mbrëmjen...

Policia kërkonte për drogë 21-vjeçarin shqiptar, hyn në banesë dhe gjen një djalë 5 vjeç, shpall në kërkim një moldave (DETAJE)
Policia greke është befasuar kur ka hyrë me forcë në një shtëpi, dhe ka gjetur...

Ish-shefi i Shërbimit sekret të Maqedonisë dënohet me 12 vjet burg, e pëson dhe ish-ministrja e Brendshme
Ish-shefi i Shërbimit sekret të Maqedonisë së Veriut, Sasho Mijallkov, u dënua të premten me...

Rasti 'Monstra', përshkallëzohet protesta e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, 7 policë të lënduar, 8 persona shoqërohen në polici
Qytetarët e Shkupit kanë zhvilluar paraditen e sotme një protestë masive, kundër vendimit të Gjylatës...

SPORT

ZYRTARE/ Sulmuesi i TIRANËS transferohet te klubi i madh EUROPIAN
Tirana ka gjetur akordin me Legian e Varshavës për të transferuar sulmuesin Ernest Muçi drejt...

Anglezët DORËZOHEN përballë GRUSHTAVE të Florian Markut, kampioni kuqezi merr një fitore të madhe në Londër
Boksieri shqiptar Florian Marku ka mbajtur ehde një herë tjetër lart flamurin kuqezi, pasi ka...

Sporti shqiptar në zi, ndërron jetë legjenda e Skënderbeut
Sporti shqiptar në zi, është ndarë nga jeta mbrëmjen e djeshme legjenda e Skënderbeut, Milutin...

SUPERLIGA/ Vllaznia i falet baltës dhe ruan diferencën me Partizanin, Tirana dhe Shehi i falen Seferit, luftë e fortë për Europën dhe mbijetesën
Ka përfunduar java e 17-të e Kategorisë Superiore në Shqipëri, e cila u mbyll me...

BOTA

Deklasifikohet raporti i CIA-s, Princi i Kurorës Saudite aprovoi planin për vrasjen e gazetarit Jamal Khashoggi
Një raport i inteligjencës amerikane ka implikuar Princin e Kurorës Saudite Mohammed bin Salman në...

Ç'do ndodhë me Eva Dumanin që ngeli në Siri? Flet konsulli i Shqipërisë: E vështirë, por kemi kanale të fshehta komunikimi, gratë zbulojnë vetëm sytë...
Konsulli i Përgjithshëm i Shqipërisë në Liban Marc Ghorayeb ka deklaruar se procesi i riatdhesimit...

Angela Merkel refuzon të marrë dozën e parë të vaksinës anti-Covid, kjo është arsyeja e fortë që e detyroi të marrë këtë vendim
Kancelarja gjermane Angela Merkel ka refuzuar që të marrë dozën e parë të vaksinës AstraZeneca...

E papritur/ Lideri i opozitës Alexey Navalny transferohet në një burg jashtë Moskës
Udhëheqësi i opozitës ruse Alexey Navalni është dërguar në një burg jashtë Moskës për të...

SHOWBIZ

Eliona Pitarka publikon FOTON intime me bashkëshortin e saj, tregon barkun e rrumbullakosur
Aktorja e njohur e humorit, Eliona Pitarka po përjeton muajt e shtatzënisë, pasi pritet të...

Lajm i KEQ për fansat e Harry Potter, aktorja e njohur Emma Watson vendos të tërhiqet nga aktrimi
Aktorja e njohur Emma Watson ka vendosur që të tërhiqet nga aktrimi. Ylli i Hollivudit arriti...

Anxhela Peristeri me veshje tradicionale në Eurovision, u bën dedikime shqiptarëve në të gjithë botën (FOTO)
Këngëtarja e njohur Anxhela Peristeri do të përfaqësojë Shqipërinë në Eurovizion për këtë vit. Teksa është...

Doni ta takoni? Nusret ndodhet në Shqipëri, ja në cilin qytet po qendron kuzhinieri i famshëm
Kuzhinieri i njohur Nusret Gokçe këto ditë po qëndron në Shqipëri. Burime të sigurta për bordo.al...

Kontaktet Tona

Mobile: +355 69 92 22201
Mobile: +355 69 92 22202
Email: info@newsbomb.al
Website: www.newsbomb.al

Të dhënat fiskale

NEWSBOMB SHPK
Adresa: Rruga Emin Duraku, Hyrja 1 Ap.14, Tiranë
NIPT: L42417011Q

Copyright © 2021 NEWSBOMB. All Rights Reserved.